



## **PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

Nr. 30

Datë: 25. 06. 2020. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Nenad Rikalo, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

SKQZ: Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

Përkthyes: Argjina Misini

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

---

### **RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**  
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.28/2020.

**2. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

Shqyrtim i kërkesës së partisë politike “Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës” për shtyrje të afatit për mbajtje të Kuvendit Zgjedhor.

**3. Raporti i Këshillave të KQZ-së:**

• **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Buxhetit i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2021-2023,
- Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor Financiar për Fondin për Mbështetje të Subjekteve Politike për vitin 2019.
- 

**4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për inicimin e hartimit të Planit Strategjik të KQZ-së, 2020-2024**

**5. Të ndryshme.**

---

## **1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së:**

**Valdete Daka:** E hapim mbledhjen e 30-të të KQZ-së, a ka dikush vërejtje në agjendën e mbledhjes ?

**Alim Rama:** Kam dërguar edhe imel, dhe dua me ju referua rregullores së mbledhjes, dhe dua me ju referua nenit 7 !

**Valdete Daka:** Nuk keni nevojë...! Ku është poenta e kësaj...?

**Alim Rama:** Respektimi i rendit, ne po përqipemi për një rend dite dhe nuk na leni mundësi anëtarëve që të propozojmë një rend dite, një pikë të rendit...!

**Valdte Daka:** Ne, për rend dite, konsultohemi vetëm me kryesuesit e këshillave dhe e përcaktojmë rendin e ditës...

Nëse keni pikë të rendit të ditës, jepe propozimin këtu dhe, vendos KQZ-ja a hynë në rend dite propozimi...

**Alim Rama:** Propozoj pikën e rendit të ditës: “Diskutim për masat e nevojshme për mbajtjen e zgjedhjeve, dhe kërkesën e IKSHP”

**Valdete Daka:** Kush është për futjen në rend dite të kësaj pike: 2 vota për, votat e tjera kundër..

Kush është për agjendën e mbledhjes, siç e kemi...?  
Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës.

Në vazhdim, u miratua procesverbali nga mbledhja nr.28/2020 e KQZ.

## **2. Aktivitetet e ZRPPC-së:**

### **Shqyrtim i kërkesës së partisë politike “Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës” për shtyrje të afatit për mbajtje të Kuvendit Zgjedhor:**

**Yll Buleshkaj:** Ne, fillimisht këtë kërkesë, nuk e kemi shqyrtuar në Këshillin për Çështje Ligjore për arsytet që dihen! Partia PSHDK, e cila ka kërkuar më herët një afat dhe tani, ka dorëzuar një kërkesë tjetër për shtyrjen përsëri të afatit lidhur me mbajtjen e kuvendit të saj. Kërkesa është bërë për shkak të kompleksitetit të gjendjes, është sjellë kjo kërkesë, dhe ne rekomandojmë për aprovim.

Arianit Elshani, kundërshtoi faktin që kërkesa, është dashur të kalojë nëpër këshill, pavarësisht kohës, angazhimit pra, t’i respektojmë rregulloret!

Lidhur me këtë pikë, Čemailj Kurtiši, tha se në një mënyrë veç është diskutuar në këshill, prandaj edhe atëherë kam propozuar që për rreth 6 muaj t'u lihet afati. Mendoj që të gjitha subjektet, brenda këtij afati do të mund t'i mbanin kuvendet...

**Valdete Daka:** Në parim, ne veç kemi diskutuar dhe në njëfarë mënyre kemi shtyrë afatin...

**Sami Kurteshi:** Jam për t'u shty afati, por kërkoj që të respektohet rregullorja e punës...

**Yll Buleshkaj:** Edhe rregullorja na mundëson në pikën nr. 7 që Zyra mund të propozoj pikë të rendit të ditës, të mos krijohet një opinion sikur ne po e shkelim rregulloren...

Në këtë pikë, diskutoi edhe Alim Rama, Eshref Vishi, dhe Arianit Elshani i cili tha se, parimisht përmbajtja është në rregull por, si çështjen vijnë deri në KQZ, duhet të kalojnë nëpër instanca të caktuara...

**Sami Hamiti:** Kemi shtyrë edhe kuvende të partive tjera, pra mos ta ndajmë veç këtë parti...

**Valdete Daka:** Atëherë, kush është për që PSHDK t'i jepet afati për mbajtjen e kuvendit zgjedhor deri më 31 tetor, 2020...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këtë rekomandim të ZRPP-së.

### **3.Raporti i Këshillave të KQZ-së**

#### **Këshilli për Buxhet dhe Financa:**

**Sami Hamiti:** Në mbledhjen e këshillit, kemi shqyrtuar dy pika: Planin e Buxhetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2021-2023. Pas një debati në këshill rreth këtij propozimi, kemi konstatuar dhe kemi dhënë shumë sugjerime për Sekretariatit. Disa prej sugjerimeve, janë në plan! Në pyetje janë zgjedhjet lokale, dhe pastaj edhe ato qendrore më 2023. Njësitë kërkeuse, janë munduar të bëjnë planifikime reale! Rekomandimi ynë është prandaj, që kjo të votohet.

**Alim Rama:** Unë, tani kam informacion se Qeveria, ia ka kthyer buxhetin KQZ-së, dhe buxhetin e ka përgjysmuar. Qeveria, nuk ka të drejtë në këtë, kështu që unë ndonëse e përkrahi rekomandimin e këshillit, tash sa ka me ndikuar kjo te realizimi i planeve tona...!?

**Sami Hamiti:** Alimi, ka të drejtë. Projektet nuk janë hequr, por janë përgjysmuar mjetet dhe konsideroj edhe unë që nuk është reale. Buxheti, ende s'ka kaluar, dhe ne do t'i kemi kontaktet. Së paku, më mirë është që të shkojmë me projektet me prioritet, se të përgjysmohen shumëat...Se, në parim edhe unë jam kundër...

**Sami Kurteshi:** Krye shefi, a mund të na informojë se për çka është fjala..?

**Yll Buleshkaj:** Po, domosdo që ka ndikim! Kemi katër projekte kapitale, dhe me tri kemi filluar me prokurimin... Por, ne kemi kërkuar që të na kthehet

buxheti sic është, ose të kemi projekte me prioritet. Përgjysmimi, nuk na mundëson realizimin e këtyre projekteve..

Informatat që kam, janë shpresëdhënëse ! Ndonëse, nuk janë kushedi çfarë shumë: projektet kapitale që kemi, janë 240 000 euro, nuk janë më shumë...

**Arianit Elshani:** A jeni konsultuar me të gjitha divizionet, departamentet lidhur me koston, sepse kemi zgjedhjet dhe se kredibiliteti i zgjedhjeve nuk duhet të vihet në dyshim ?

**Yll Buleshkaj:** Kemi bërë analiza, krahasime, por edhe reduktime së paku rreth stafit që e angazhojmë...! Nivelet operacionale, nuk janë prekur por pjesët tjera do të jenë më të reduktuara. Drafti i buxhetit që është para jush, parasheh kërkesat ligjore...Por, ende jemi në fazat parashikuese, por do të kursejmë nga buxheti kudo që është e mundur...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e këshillit lidhur me Planin e Buxhetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve: 2021-2023.

**Sami Hamiti:** Në këshill, kemi shqyrtuar edhe Raportin Vjetor Financiar për Fondin për Mbështetje të Subjekteve Politike për vitin 2019. Në raport, pasqyrohen shpenzimet që kanë ndodhur. Alimi, e ngriti një pyetje se pse pagesa për grupet parlamentare vijnë dhe certifikohen në KQZ, por mbasi që grupet parlamentare nuk janë entitet buxhetor, ka mbetur që të vijnë përmes KQZ-së...

Si të këtitillë, e kemi propozuar të vijë në KQZ, dhe të votohet...

**Alim Rama:** Kjo mu ka dukë një punë shtesë e Sekretariatit, kurse raporti si i këtitillë, ka pak informata për financat tjera që shkojnë për partitë politike. Unë kërkoj që raporti të cekë kohën se kur partitë politike kanë marrë fondet, sepse kjo është me rëndësi. Raportet e partive, të sillen me kohë, jo mbas marsit...A e ka vërtetua KQZ se partitë, a i përmbushin të gjitha kriteret në raport. Ato, duhet edhe të publikohen në ueb faqe. Unë, po vërej se jo të gjitha aspektet e ligjit janë plotësua...

**Yll Buleshkaj:** Ne, vetëm i transferojmë fondet...! Por, ekzistojnë dy interpretime: t'i publikojmë raportet si të audituara, apo t'i publikojmë raportet ashtu siç, na vijnë, të pa audituara... Ne, as si zyre dhe as si KQZ, nuk bëjmë auditim... Kuvendi, bënë auditimin... A i përmbahen partitë afateve apo jo, ne në të kaluarën edhe kemi ndërmarrë masa...

**Valdete Daka:** Në këtë rast, jemi duke fol për fondin e subjekteve të partive politike, dhe për raportet të cilat janë dy: raporti i fushatave zgjedhore, dhe raporti i fondit...Dhe ne, vetëm i shpërndajmë fondin, asgjë tjetër...

**Sami Kurteshi:** Për mua, është pyetje pse KQZ me e luajte rolin e arkatarit të partisë politike, dhe tjetra, ky raport ma la një shije se janë trajtuar vetëm dy kategori: paga dhe mëditje, dhe mallra dhe shërbime. A ka tjetër lloj shpenzimi...?

Për mua, rëndësi ka: problemi i financimit të partive politike! A kemi ne mundësi që ky problem të shihet..

**Valdete Daka:** Ky problem, pa të drejtë i është vu si barrë KQZ-së, dhe me atë ligj KQZ nuk i është dhënë mundësi kontrolli. Ne nuk mund të ndërhyjë, pa u ndryshue ai ligj! Na i dërgon qeveria 4.5 milion në xhirollogari, dhe ne i shpërndajmë.

Ne, s'kemi mundësi ndërhyrjeje...pra, ne jemi të përjashtuem që ligjërisht të ndër marrim diçka...

Në vazhdim, lidhur me këtë temë, diskutuan: Alim Rama, Valdete Daka, Sami Hamiti, dhe Arianit Elshani.

Në fund, anëtarët e KQZ –së, miratuan këtë raport.

#### **4.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për iniciimin e hartimit të Planit Strategjik të KQZ-së, 2020-2024**

**Yll Buleshkaj:** E keni pranuar një kërkesë që të iniciohet procesi për një plan strategjik! Është një prej dokumenteve më të rëndësishme, dhe se mendojmë që të krijohet një grup punues i përbashkët. Do të punojmë mbi bazë të metodologjive të caktuara, dhe tjetra, në fund të jenë tri produkte: raporti i zbatimit të planit, një dokument i objektivave strategjik, dhe një plan indikativ që përfshinë strukturën e realizimit. ( formimi i grupeve, afatet etj.) E kemi diskutuar, dhe mendojmë që ta kemi një draft së paku brenda tre muajve...

**Valdete Daka:** Është mirë ta kemi këtë plan, dhe jemi ndër institucionet e pakta që realizojmë dhe miratojmë plan strategjik...

**Sami Kurteshi:** Jam i interesuar me qenë pjesë ku punohet në planin strategjik. Pra, mendoj që duhet ta caktojmë një mbledhje me këtë pikë të rendit të ditës. Parimisht, jam i interesuar me qenë pjesë e grupit sepse, ky dokument e drejton punën e institucionit...

**Valdete Daka:** Është mirë me formue një grup punues...

**Eshref Vishi:** Është shumë e rëndësishme që KQZ të ketë një plan strategjik! Kujtoj që KQZ, ka një përvojë paraprake, ka ushtrua përgjegjësitë e veta kushtetuese dhe ligjore në administrimin e proceseve zgjedhore, ka pasur më herët një plan të këtillë... Një praktikë të mirë që e ka KQZ, është edhe organizimi i fidbekeve pas proceseve që jep mundësi me i identifikaur lëshimet apo dobësitë, gabime që e kanë përcjellë atë proces zgjedhorë...

Strategjia, është një dokument shumë serioz, dhe grupi punues duhet të ketë një qasje shumë serioze në hartimin e këtij dokumenti...! Duhet për mendimin tim, të hartohet edhe një raport jashtë grupit punues që e rishikon zbatimin e strategjisë, dhe këtë, më së miri e bën Sekretariati...

Në këtë pikë, diskutuan më tej edhe: Yll Buleshkaj, Valdete Daka, Arianit Elshani, Eshref Vishi i cili foli rreth objektivave, qëllimeve paraprake, ku po duam të arrijmë...!

**Valdete Daka:** Është propozimi: 7 + 7

Ne, të vendosim për anëtarët e KQZ-së, kurse Sekretariati le ta caktoj grupin...

Atëherë, në parim kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan kërkesën për inicimin e hartimit të Planit Strategjik të KQZ-së, 2020-2024.

Tani, ta formojmë grupin nga radhët e KQZ-së:

1. *Eshref Vishi,*
2. *Sami Hamiti,*
3. *Ibrahim Selmanaj,*
4. *Alim Rama,*
5. *Artan Asllani,*
6. *Arianit Elshani,*
7. *Nenad Rikallo.*

Kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan grupin për hartimin e Planit Strategjik të KQZ-së, 2020-2024 ( Sami Kurteshi dhe Alim Rama, nuk ishin prezentë në momentin e votimit)

## **5. Të ndryshme.**